



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priliceno / Prodato Received / Delivery	18.01	202	4	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinita Org / Unit	SKPM/Strukc	319/2024	1/1	Sasia Kolicina Quantity



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1416/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-Kryetar, Jeton Koca dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1416/2023 të datës 15.11.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi

kundër vendimit me Nr.13-373/23 të datës 06.10.2023 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë në Komunën e Podujevës, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 17.01.2024 mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1416/2023 e datës 15.11.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër me Nr.13-373/23 i datës 06.10.2023 i Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë në Komunën e Podujevës.

A r s y e t i m

Komuna e Podujevës në bazë të Ligjit Nr.Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, neni 38 paragrafi (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) për Pranim dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 40, fillimisht më datë 21.08.2023 ka njoftuar për konkursin Lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës "Drejtor i Qendrës për Punë Sociale" në Komunën e Podujevës me numër reference Nr.ref. RN00011852, ndërsa afati për aplikim ka qenë nga data 05.09.2023 deri 12.09.2023, në të cilin konkurs ka aplikuar ankuesi në këtë procedurë.

Në bazë të njoftimit të datës 19.09.2023 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore për verifikimin paraprak të aplikacioneve për procedurën Lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës ‘ ‘Drejtor i Qendrës për Punë Sociale’ ’ në Komunën e Podujevës ankuesi është përfshirë në listën e shkurtër si kandidatë i vetëm në këtë procedurë.

Ndërsa më datë 29.09.2023 pas zhvillimit të intervistës me gojë Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës ka nxjerrë njoftimin me numër Nr.13-111/01-0072010/23 për përfundimin e procedurës së rekrutimit Lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës ‘ ‘Drejtor i Qendrës për Punë Sociale’ ’ me arsyetimin se: përfundimi i kësaj procedure përfundon pa fitues për shkak se kandidati nga vlerësimi që është bërë nga komisioni nëpërmjet intervistës, ku është vlerësuar jetëshkrimi/CV, njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për pozitën e punës nuk ka arritur të ketë 60 apo më shumë pikë të kërkuara sipas legjislacionit në fuqi.

Ankuesi i pakënaqur me Njoftimin e datës 29.09.2023 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës, me datë 02.10.2023 ka parashtruar ankesë tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ndaj vlerësimit të intervistës në konkursin lëvizje brenda kategorisë me pretendimin ankimor se i plotëson kushtet pasi që kam qenë kandidati i vetëm që i plotësojë kushtet e konkursit.

Ndërsa me datë 06.10.2023 Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje brenda kategorisë ka nxjerrë vendimin me numër Nr.13-373/23 me të cilin ankuesit i ka refuzuar ankesën ndaj vlerësimit të intervistës me konstatimin si në vijim: KVBLK pas vlerësimit të jetëshkrimit/CV, njohurive, aftësive apo cilësive të kërkuara për pozitën e punës për të cilën ka aplikuar ankuesi, e ka vlerësuar atë me gjithsej 59.2 pikë. Duke pas parasysh që ankuesi nuk është vlerësuar me gjashtëdhjetë (60) e më shumë pikë, procedura e lëvizjes brenda kategorisë ka përfunduar pa kandidat fitues.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin me numër me Nr.13-373/23 i datës 06.10.2023 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë në Komunën e Podujevës ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6981/2023 në Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se i plotëson kushtet pasi që kam qenë kandidati i vetëm që i plotësojë kushtet e konkursit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.11.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Podujevës, ndërsa Këshilli më datë 23.11.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Podujevës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit, me datë 27.12.2023, Kryesuesi i Këshillit ka nxjerrë vendimin VK/2023 përmes të cilit ankesës së ankuesit A.nr.1416/2023 i ka vazhduar afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë pune.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 6981/2023 të datës 15.11.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkurs Lëvizje Brenda kategorisë për pozitën "Drejtor i Qendrës për Punë Sociale" me numër reference RN00011852 i datës 21.08.2023; Vendim nga Komisioni i Vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë me numër Nr.13-373/23 i datës 06.10.2023; Ankesa e drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës e datës 02.10.2023; Njoftim për përfundimin e procedurës së Rekrutimit Lëvizje Brenda Kategorisë me numër Nr.13-111/01-0072010/23 i datës 29.09.2023; Letër njoftim i Vërtetimit nga QPS për me numër protokollit 2145 i datës 11.09.2023; Vërtetim nga Njësia e burimeve njerëzore për me numër Nr.13-351/23 i datës 11.09.2023; Certifikatë mbi dënimet penale e e datës 08.09.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për i datës 31.01.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për i datës 12.01.2022; Certifikatë nga "Dituria" për i datës 10.01.2005; Certifikatë nga MPMS për për muajin Nëntor 2015; Certifikatë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për i datës 23.05.2022; Certifikatë nga "Ofap" për e vitit 2023; Certifikatë nga "GIZ" për për muajin Janar 2020; Certifikatë nga MPMS për . për muajin Nëntor 2011; Certifikatë nga "The European Children's Trust" për për muajin Korrik 2001; Certifikatë nga "Adra" për për periudhën Janar-Dhjetor 2000; Certifikatë nga "OIM" për për periudhën 18.06.2001-22.06.2001; Certifikatë Licencimi me numër nr.75 për e datës 17.05.2021; Certifikatë Licencimi me numër nr.075/16R për e datës 05.12.2016; Certifikatë nga "KOMF" për e datës 11.10.2023; Certifikatë nga Qendra MVPT/PVPT për për muajin Tetor 2023; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës për me numër Nr. 552 i datës 10.10.2003; Pliko me numër R5621032 i datës 09.11.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 20.10.2023; Përgjigje në ankesë e datës 23.11.2023; Vendim për themelimin e komisionit për vlerësim për lëvizje brenda kategorisë me numër Nr.02-020/04-0070145/23 të datës 21.09.2023; Lista e aplikantëve nga SIMBNJ me numër reference RN00011852; Njoftim i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës me numër Nr.13-359/2023 i datës 19.09.2023; Vlerësimi Individual i kandidatëve për vendin e punës për pozitën "Drejtor i Qendrës për Punë Sociale" për kandidatin të datës 28.09.2023; Vlerësimi Individual i kandidatëve për vendin e punës për pozitën "Drejtor i Qendrës për Punë Sociale" për kandidatin të datës 28.09.2023; Vlerësimi Individual i kandidatëve për vendin e punës për pozitën "Drejtor i Qendrës për Punë Sociale" për kandidatin të datës 28.09.2023; Vlerësimi Individual i kandidatëve për vendin e punës për pozitën "Drejtor i Qendrës për Punë Sociale" për kandidatin të datës 28.09.2023; Njoftim i Njesisë së Burimeve Njerëzore për përfundimin e procedurës së rekrutimit lëvizje brenda kategorisë me numër Nr.13-377/23 i datës 06.10.2023; Formulari për kërkesë apo ankesë me numër protokollit 13-334/07-0072288/23 të datës 02.10.2023; Aplikacioni i i datës 11.09.2023; Vërtetim nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për të datës 19.02.2021; Vërtetim nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për të datës 11.09.2023; Rezultatet e vlerësimit; Vendimi i KPMSHCK me numër VK/2023 me numër protokollit 7681/2023 i datës 27.12.2023;



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Kolegji i Këshillit në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit analizoi kriteret e konkursit për pozitën përkatëse të punës dhe konstatoi se kriteret formale për pozitën e punës "Drejtor i Qendrës për Punë Sociale" në Komunën e Podujevës për një (1) pozitë me numër të referencës RN00011852, Kërkesat e përgjithshme formale kanë qenë:

Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve, Psikologji/Sociologji, Punë Sociale, Logoped;

Përvoja e punës e kërkuar: Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale;

Në bazë të njoftimit të datës 19.09.2023 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore për verifikimin paraprak të aplikacioneve për procedurën Lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës "Drejtor i Qendrës për Punë Sociale" në Komunën e Podujevës ankuesi është përfshirë në listën e shkurtër si kandidatë i vetëm në këtë procedurë. Ndërsa më datë 29.09.2023 pas zhvillimit të intervistës me gojë Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës ka nxjerrë njoftimin me numër Nr.13-111/01-0072010/23 për përfundimin e procedurës së rekrutimit Lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës "Drejtor i Qendrës për Punë Sociale" me arsyetimin se: përfundimi i kësaj procedure përfundon pa fitues për shkak se kandidati nga vlerësimi që është bërë nga komisioni nëpërmjet intervistës, ku është vlerësuar jetëshkrimi/CV, njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për pozitën e punës nuk ka arritur të ketë 60 apo më shumë pikë të kërkuara sipas legjislacionit në fuqi.

Ankuesi i pakënaqur me Njoftimin e datës 29.09.2023 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës, me datë 02.10.2023 ka parashtruar ankesë tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ndaj vlerësimit të intervistës në konkursin lëvizje brenda kategorisë me pretendimin ankimor se i plotëson kushtet pasi që kam qenë kandidati i vetëm që i plotësojë kushtet e konkursit. Ndërsa me datë 06.10.2023 Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje brenda kategorisë ka nxjerr vendimin me numër Nr.13-373/23 me të cilin ankuesit i ka refuzuar ankesën ndaj vlerësimit të intervistës me konstatimin si në vijim: KVBLK pas vlerësimit të jetëshkrimit/CV, njohurive, aftësive apo cilësive të kërkuara për pozitën e punës për të cilën ka aplikuar ankuesi, e ka vlerësuar atë me gjithsej 59.2 pikë. Duke pas parasysh që ankuesi nuk është vlerësuar me gjashtëdhjetë (60) e më shumë pikë, procedura e lëvizjes brenda kategorisë ka përfunduar pa kandidat fitues.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin me numër me Nr.13-373/23 i datës 06.10.2023 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë në Komunën e Podujevës ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6981/2023 në Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se i plotëson kushtet pasi që kam qenë kandidati i vetëm që i plotësojë kushtet e konkursit.

Në kuptim të vendosjes meritorë lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit, i'u referua dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkitazi me rregullimin e procedurës dhe përgjegjësinë disiplinore të nëpunësve civil, konkretisht Kolegji

analizoj: Nenin 38 paragrafi 1 dhe 2, me të cilin është përcaktuar se: "1. Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë. 2. Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni".

Nenin 38 paragrafi 5 dhe 6, me të cilin është përcaktuar se: "5. Vlerësimi i kandidatëve të interesuar kryhet nga një komision vlerësimi, i krijuar në çdo institucion, bazuar në një intervistë me kandidatët. Komision përbëhet nga pesë anëtarë, njëri nga të cilët është domosdo përfaqësues i Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit. 6. Në përfundim të vlerësimit, Komisioni mund të vendosë: 6.1. përzgjedhjen e kandidatit më të suksesshëm për t'u emëruar në vendin e lirë, apo; 6.2. përfundimin e procedurës, pa asnjë të përzgjedhur, në rast se asnjë nga kandidatët e interesuar nuk vlerësohet i suksesshëm për atë vend të lirë të punës.". Po ashtu Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht: Nenit 44 paragrafi 1 dhe 2, me të cilin është përcaktuar se: "1.Konkurimi për lëvizjen brenda kategorisë zhvillohet në dy faza: 1.1. verifikimi paraprak i kandidatëve; dhe 1.2. vlerësimi i kandidatëve. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ, ndërsa vlerësimi i kandidatëve kryhet nga Komisioni i Vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, krijuar sipas nenit 47 të kësaj Rregulloreje" Nenit 45 paragrafi 1, 2 dhe 3, me të cilin është përcaktuar se: "1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurohet. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ. 3.Në përfundim të verifikimit paraprak NJBNJ përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lire. Vetëm këta kandidatë kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin". Nenit 47 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4, me të cilin përcaktohet se: "1.KVLBK zhvillon një intervistë me gojë me kandidatët. 2.Nëpërmjet intervistës, KVLBK vlerëson jetëshkrimin/CV, njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurimi. 3.KVLBK përgatit përpara fillimit të intervistës një grup pyetjesh. Intervista që zhvillohet është e strukturuar dhe me pyetje të njëjta për të gjithë kandidatët e cila përgatitet në ditën e zhvillimit të intervistës.. 4.Vlerësimi maksimal në intervistën me gojë është njëqind (100) pike". Nenit 48 paragrafi 1 dhe 2, me të cilin përcaktohet se: "...Pikët e çdo anëtari për çdo vlerësim mblidhen dhe pjestohen me pesë. 2.Në përfundim të fazës të vlerësimit, pikët e përfituara nga secili kandidat në secilën nga hapat e vlerësimit, mblidhen dhe shuma e pikëve për të gjithë hapat e vlerësimit përbën vlerësimin përfundimtar të konkurimit".

Nenit 49 paragrafi 1, 2 dhe 3, me të cilin përcaktohet se: "1.KVLB në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njesisë Përgjegjëse brenda njëzetë e katër (24) orëve nga miratimi i saj. 2.Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurimi. 3.Nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar me gjashtëdhjetë 60 e më shumë pikë, procedura e lëvizjes brenda kategorisë përfundon pa kandidat fitues".

Bazuar në dispozitat e lartcekura, Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisionit për Vlerësimin e Lëvizjes Brenda Kategorisë, nëpërmjet intervistës, vlerëson jetëshkrimin/CV, njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurimi, rrjedhimisht me



asnjë dispozitë ligjore për procedurat e lëvizjes brenda kategorisë sipas Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nuk është përcaktuar që vlerësimi i jetëshkrimit apo CV-së bëhet ndaras por kjo bëhet gjatë vlerësimit të intervistës me gojë respektivisht ky vlerësim inkorporohet në pikët e vlerësimit me gojë, mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, vlerëson se Komisioni për Vlerësimin e Lëvizjes Brenda Kategorisë në Komunën e Podujevës, vlerësimin e intervistës me gojë për kandidatin në këtë proces e ka bërë në pajtim me dispozitat e lartcekura, rrjedhimisht ankuesi nga komisioni është vlerësuar me gjithsejtë 59.2 pikë që kanë qenë të pamjaftueshme për emërim.

Gjithashtu Kolegji ka konstatuar se përfshirja e ankuesit si kandidatë i suksesshëm në listën e ngushtë është bërë në kundërshtim me kriteret formale të konkursit, sepse ankuesi ka diplomë të fakultetit juridik, ndërsa një diplomë e tillë nuk është kërkuara në konkursin e shpallur nga ana e Komunës së Podujevës.

Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni për Vlerësimin e Lëvizjes Brenda Kategorisë me rastin e nxjerrjes së vendimit të datës 06.10.2023, ka vlerësuar në pajtim me nenin 48 ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenin 50 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sepse ka konstatuar drejtë dhe saktë gjendjen faktike dhe juridike.


Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1416/2023

Çlirim Zeka


Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Podujevës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.